



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.645/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurës M. F, sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr. 1377/15 të dt.29.9.2015 për shkak të veprës penale : asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurës M. F dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi, dhe të me dt.30.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura M. F e lindur me dt.31.12.1995 në G, L nr.27 – B – S, e bija dhe nënës Z e gjinisë S, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se :

Me dt. 15.7.2015, rreth orës 10:00 në rrugën Koço Flloku nr. 6 – Pejë , me dashje dëmton pasurinë e luajtshme –pronë e të dëmtuarit T .R , në atë mënyrë që e pandehura ditën kritike kishte shkuar tek shtëpia e ish bashkëshortit të saj T.R në vendin e sipërshtënuar dhe me tu takuar me të njëjtin pas një zënke verbale në mes tyre , e pandehura në shenjë revolte me një qelës e gërvisht veturën e llojit Taureg duke shkaktuar dëme (një vijë) në anën e djathtë .

-me çka ka kryer veprë penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 333 par 1 të KPK-së I SHQIPTON

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurës i behët me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ajo sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro –kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 30 euro 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt. 29.9.2015 kundër të pandehurës M. F ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.1377/15 , për vepër penale : asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par 1 të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurën ta shpallë fajtores , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar e pandehura – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë e pandehura e ka bërë ashtu siç e parashih ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe asnjë mënyrë e ka pranuar.

Meqenëse e pandehura e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë , raportet e mia me bashkëshortin , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.30.5.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .